



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJITIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME DETARE
KAPITENERIA E PORTEVE
KAPITENERIA E PORTIT SHENGJIN

Nr. 01 prot.

Shëngjin, me dt: 15/ 01 / 2021

I N F O R M A C I O N
(V J E T O R)

Drejtuar: Z: TOMOR HARIZI

Zv/Drejtor i Përgjithshëm & Kapiten i Porteve, D.P.D, D U R R Ë S

Lënda: “Informacion mbi aktivitetin e punës të Kapiteneris së Portit Shëngjin për”

VITIN - 2020 !

Datë: 15/ 01 / 2021

I nderuar, z: KAPITEN!

Ju informojmë se aktiviteti i veprimtarisë së punës, gjatë: **VITIT – 2020**, në sektorin e Kapitenerisë së Portit Shëngjin, është zhvilluar në rregull dhe pa vërejtje. Kjo bazuar në ligjet, rregulloret, instruksionet në fuqi, në objektivat e punës për çdo inspektor të përcaktuara ne Formularin e vlerësimit të 6-mujorit I^{Rë} dhe të II^{të}, në grafikun mujor të shërbimit, si dhe në bazë të urdhërave dhe udhëzimeve të vazhdueshme të dhënë nga ana Juaj,për mbarvajtjen e punës tonë.

Aktiviteti kryesorë i punës së inspektorëve të Kapitenerisë së Portit Shëngjin ka konsistuar në: Kryerjen e praktikave të lira detare; Në mbërritje dhe nisje të anijeve nga Porti Shëngjin; Në monitorimin e trafikut detare ; Në zbatimin e ligjshmërisë detare. Të gjitha keto detyra janë kryer më së mirë nga ana e inspektoreve dhe nuk kemi patur asnjë lloji incidenti detarë dhe probleme të ndryshme e të padëshirueshme.

Është zbatuar me përpikmëri grafiku i shërbimit të miratuar për të gjithë inspektorët e kap –

itenerisë, si dhe plani ditorë i vendosjes së anijeve në kalatat e portit në b/punim me dispecerinë e portit gjatë gjithë vitit.

Panë realizuar dhe vënë në zbatim: “Objektivat e punës, me të gjithë inspektorët e Kapitenerisë për vitin – 2020”.

Mbas dates: 10.03.2020, e në vazhdim është punuar nga ana e personelit të Kapitenerisë në kushtet e izolimit nga rreziku i pandemisë **COVID – 19**, mbarë botërore, duke zbatuar të gjithë portokollet zyrtare gjatë gjithë kohës dhe në vazhdim. Mbas Qershorit dhe në vazhdim, në bazë të protokolleve zyrtare, për këtë pandemi, po zbatohet: **V.K.M Nr. 426; datë: 01.06.2020**, si dhe **Udhëzimit Nr.2245/1, dt 10.03.2020**, të **M.SH.M.S.**; **“Për marrjen e masave të nevojshme në ndalimin e përhapjes së „ COVID – 19”.**

Gjatë kësaj periudhe në Kapitenerinë e Portit Shëngjin është punuar me kapacitet të plotë dhe personel present në punë. Kjo mbështetur dhe në bazë të udhëzimeve të dërguar nga D.P.D-ja. Gjatë gjithë kësaj kohe i është ofruar shërbim pandëprerje të gjitha subjekteve shtetërore dhe private me aktivitet detarë në Portin Shëngjin, në kohë, me cilësi e në bazë të të gjitha ligjeve në fuqi. Nuk ka patur asnjë lloji problem.

Gjatë VITIT - 2020, në Portin e Shëngjinit janë përpunuar anijet sipas tabelës së më poshtëme:

Nr.	Tipi i anijeve të përpunuara	Sasia (Hyrë)	Sasia, (ton) e mallrave të importuara	Sasia (Dalë)	Sasia, (ton) e mallrave të eksportuara	Nr.turist. Hyrë / Dalë
01.	TRANSPORTI	99	195.846,17T (Klinker + 2kont+heekur nd.)	99	41.419,26T (zhavorr+skrap)	=
02.	TURISTIKE	13	=	12	=	41 / 37
03.	CISTERNË	03	=	03	=	=
04.	YACHT	=	=	=	=	=
05.	PASAGJERE	=	=	=	=	=
06.	PESHKIMI	05	=	06	=	=
	TOTALI:	120	195.846,17T	1120	=	41/ 37

Aktiviteti i anijeve transportit, gjatë VITIT - 2020, krahasuar me një vit më parë pothu - ajse ka qënë i njëjtë me atë të një viti më pare, gjë që tregon se pandemia nuk ka luajtur ndonjë rol frenues në këtë sektor jetik.

Por gjatë vitit – 2020, në rënie ka qënë, numri i mjeteve turistike në një masë sa 1/3 e mjeteve turistike që kanë prekur portin Shëngjin një vit më pare. Kjo si shkak i pa – ndemisë, nga **COVID – 19**.

Si probleme:

1. **M**jetet e komunikimit në sallën e M.T.D pothuajse janë inekzistente, nuk punojnë. Komunikohet me anë të një Radio V.H.F – dore, inspektori në nisje – mbërritje dhe radio **“SAILOR”**, V.H.F, në sallën e M.T.D
*Për të realizuar komunikim të vazhdueshem me mjetet lundruese të të gjitha llojeve kam vendosur në sallën e M.T.D, të kapitenerisë radio **“SAILOR”**, ish pajisje e godinës së vjetër.*
2. **M**ungesa e sinjalit të internetit në zyrën e Kapitenit të Portit, është i dobët herë – herë dhe me ndërprerje.
3. **N**ë situatë **“Black – out”**, gjë që ndodhemi shpesh si rezultat i ndërprerjes së energjisë elektrike, është e domosdoshme vendosja në punë e **“INVERTERIT** kjo për mungesë të baterive.

Gjatë gjithë: **VITIT - 2020**, janë ushtruar kontrole të vazhdueshme nga ana e Kapitenit të Portit në drejtim të kryerjes së shërbimit nga ana e inspektorëve, si dhe për zbatimin e masve në ruajtje nga mos infektimi të virusit **“COVID – 19”**, e ndalimin e mos përhapjes së tij. Këto kontrole janë ushtruar në ditët e shtuna, diela, fastave dhe ditëve të zakonshme . Këto kontro –lle kanë patur si qëllim të vetëm: zbatimin e detyrave të shërbimit, orarit të punës dhe ushtri –mit të kompetencave në zbatim të ligjive, urdhërave dhe rregulloreve në fuqi. Gjatë këtyre kontrolleve nuk është vërejtur ndonjë mangësi në kryerjen e shërbimit.

Gjatë **VITIT – 2020**, janë kryer kontrole dhe pajisur me: **RAPORT - VERIFIKIMI**, për më shumë se në **57**(pesëdhjetë e shtatë) mjete të vogëla lundrimi, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rajonet: Portit Shëngjin, grykë derdhje Lumit Drin, Grykë derdhje lumit Mat e Ishëm; Liqenin e Shkodrës dhe Liqenet e Laç – Vau Dejës, Koman e Fierzë, nga ana e Kapitëtit të Portit.

Gjatë vitit-2020, janë ushtruar disa kontrole të detajuara, nga një Grup pune i miratuar nga D.P.D-ja, si dhe nga ana e vetë Kapitenit të Portit Shëngjin, për të gjitha mjetet lundruese që po ushtrojnë aktivitet në Liqenin e Komanit, e Liq. Shkodrës Nga kontrollet e ushtruara me në këto rajone lumore e liqenore, mbi këto mjete, u vërejt se: *Në këtë pjesë të Liqenit të Komanit, vazhdojnë përsëri të ushtrojnë aktivitet të përditshëm ujorë në transport njerëzish një numër i konsiderueshëm mjetesh të vogla lundruese, dhe me gjithë vërejtjet dhe masat që u morën nga ana jonë në kontrollet e ushtruar mbi këto mjete, ku pjesa më e madhe e tyre, rreth 90% , janë pa dokumentat përkatës, të lëshua –ra nga Zyra e Rregj. të Mjeteve Lundruese në D.P.D, Durrës, ashtu dhe nga Rr.D.Sh, Durrës. E njëjta situatë është edhe në Liq. e Shkodrës, por me një ndryshim se mjetet këtu , pjesa më e madhe e tyre, përdoren pëpeskëm artisanal dhe jo për transport njerëzish sin ë Liq. e Komanit.*

Gjatë sezonit **Turistik – 2020**, për të minimizuar sado pak eliminimin e situatave të padësh iruara, në këto rajone të brëndshme ujore dhe në bazë të: **Udhërave me Nr. 42; 43, date; 29.06.2020**, të Drejtorit të Përgjithshëm të D.P.D-ës, është bërë e mundur mbulimi me inspektorë kalate në kalatën e mjeteve në Liq. Komanit, me anë të inspektorëve; **z. SHEFIK SHKAMBI dhe z. REI OSHAFI**, në punë me kohë sezonale, për një periudhë: **nga dt.01.07.2020, deri më dt. 30.09.2020**, si inspektor kalate në Liqenin e Komanit.

Gjatë vitit -2020, në muajin Shtator, në ambjentet e Kapitenerisë së Portit Shëngjin, u zhvillua testimi i marinarëve të flotës peshkimit, të Portit Shëngjin, për pajisjen nga ana e tyre me Dëshmi të reja kualifikimi në drejtimin e mjeteve të peshkimit. Ky testim u krye nën vëzhgim dhe drejtimin e Komisionit të veçantë të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i D.P.D-ës, Durrës.

Me anë të Kapitenit të Portit është marrë pjesë aktive në të gjitha takimet që janë zhvilluar nga Njësia Adm. Shëngjin, Drejtoria e Portit Detarë Sh.A, Shëngjin, Stacioni i Pol. Kufitare Shëngjin, Drejtoria e Degës së Doganës, Shëngjin, si dhe Rojes Bregdetare, në kuadër të bash – këveprimit dhe bashkëpunimit ndër institucional për mbarëvajtjen e punës sonë.

Janë dërguar rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, Informacionet ditore, mujore si me eprrorët në varësidirekte ashtu dhe me organet shtetërore që bashkëveprojnë në aktivitetin e tyre në portet e R.Sh.

Bashkangjitur po ju dergojmë:

- Anijet, mallrat, personat HYRË në: **VITIN – 2020!**
- Anijet, mallrat, personat DALË në: **VITIN – 2020!**
- Anijet që kanë prekur Portin e Shëngjinit për muajin: **VITIN - 2020!**

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Me respekt
Kapiteni i Portit Shëngjin
SHKËLQIM CELAMI